



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:282805

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05691903

**C-IV-13-1826**

*Parashtruesi i kërkesës*

**R B**, nga Hani i Elezit, të cilin e përfaqëson avokat J R, nga Ferizaji

*Kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) ( NSH - PMN “Sharr” në likuidim)**, Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 16 maj 2024, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. Vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI042-4980 datë 21 gusht 2013.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 20 shtator 2013, ankuesi parashtror pranë DHPGJS një kërkesë, të emërtuar kundërshtim, për rishqyrtimin e Vendimit GJI042-4980 datë 21 gusht 2013 (tani e tutje Vendimi), lëshuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit të AKP (tani e tutje: AL), me të cilin vendim ankuesit i është refuzuar kërkesa me të cilën, sipas Vendimit, është kërkuar kompensimi për paga të papaguara, për periudhën nga muaji janar 2004, në shumë prej 15,496.10 (një pesë katër nëntë gjashtë një zero) Euro, ndaj NSH PMN “Sharr” në likuidim.

Ankuesi Vendimin e AL e kundërshtoj për shkak të:

- Vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, dhe
- Zbatimit të gabuar të dispozitave materiale.

Ankuesi pohon ishte në marrëdhënie pune me “Beteiligungs Bmbh- Hani i Elezit” dhe atë në bazë të vendimit nr. 620 datë 4 dhjetor 2003.

Ankuesi tutje e kundërshtoj Vendimin e AL lidhur me parashkrimin e kërkesave.

Ankuesi përfundimisht pohoj se i është drejtuar disa herë AKP, mbi realizimin e kërkesës, dhe gjithnjë ka marrë premtime se kërkesa do të shqyrtohet në procedurë të likuidimit.

Nga të gjitha arsyet konsideron se Vendimi i AL është ligjor andaj kërkon që kërkesa e tij, mbi pagat, të aprovohet.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e Vendimit, 620/70 datë 4 dhjetor 2003, lëshuar nga ana e “Beteiligungs GmbH-Hani i Elezit”, mbi dërgimin e ankuesit në pushim me pagesë ( në tekstin në vijim AKTVENDIMI), dhe
- Kopja e Aktgjykimit, Ac.nr. 580/2006 datë 10 korrik 2006, lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Me këtë Aktgjykim është vërtetuar Aktgjykim i Gjykatës Komunale në Kaçanik, C.nr. 24/04 datë 3 dhjetor 2004, sipas të cilit është aprovuar kërkesë padia e paditësve ( grupit të punëtorëve e ndër ta edhe ankuesit), kundër të paditurit “Shar Beteiligungs” GmbH-Hani i Elezit, dhe është anuluar vendimi nr. 620 datë 4 dhjetor 2003, mbi dërgimin në pushim me pagesë ( në tekstin në vijim AKTGJYKIMI).

Duke vepruar sipas urdhrit të gjykatës, datë 23 janar 2014, ankuesi parashtroj kopjen e autorizimit për përfaqësuesin e tij.

Sipas urdhrit të gjykatës, AKP me 6 mars 2014 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj kërkesën për rishikim-kundërshtimin duke e konsideruar si të pabazuar. AKP pohoj se AL me rastin e vendosjes dispozitat ligjore i ka zbatuar në mënyrë të drejtë. AKP gjithashtu konsideron se AKGJYKIMI vetëm se ka shfuqizuar një vendim dhe nuk i njeh të drejtën në kompensim financiar. Për më tepër AKP konsideron se kërkesa mbi pagat e ankuesit konsiderohet e parashkruar. Nga gjitha arsyet propozon që kërkesa për rishikim-kundërshtimi të refuzohet si i pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigja e AKP ju dorëzua përfaqësuesit të ankuesit me 29 mars 2014.

Nuk u parashtrua përgjigje.

### **Arsyetimi Ligjor**

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrësit e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Ankuesi nuk ka ofruar asnjë argument dhe provë me të cilat do të dëshmohej e drejta në kompensimin në paga, për periudhën e kërkuar.

AKTGJYKIMI i prezantuar nga ankuesi, me kërkesën e tij për rishikim-kundërshtim, paraqet obligimet respektivisht detyrimet e të paditurit “Shar Beteiligungs” GmbH-Hani i Elezit, e jo

edhe të NSH-PMN “Sharr”. Subjekti “Shar Beteiligungen” GmbH-Hani i Elezit, ashtu siç qëndron në AKTKGJYKIM paraqet një subjekt tjetër e jo edhe NSH ndaj së cilës është zhvilluar procedura e likuidimit të NSH.

Gjithashtu edhe AKTVENDIMI i prezantuar shihet se është lëshuar nga ana e “Beteiligungs GmbH-Hani i Elezit” e jo nga NSH PMN “Sharr”.

Për më tepër gjykata konsideron se lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. Pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7 parashihet përmbushja e kërkesave përfshirë kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë

Ankuesi, nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat e pa-paguara ashtu që do të dëshmonte, me dëshmi materiale, ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 por edhe paragrafit 1.7 (kërkesat e pasiguruara) të po të njëjtit nen, si edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

### **Taksa Gjyqësor**

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për DHPGJS secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar